

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-910 N

URË NDËRKAPJEJE & MBROJTJE KUNDËR KORRODIMIT TË KONSTRUKSIONEVE PREJ BETONARMEJE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-910 N është një material prej një përbërësi, me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere për veshje (si shtresë), i cili përmban tym silici (silica fume) dhe që përdoret si prajmer për ngjitje dhe si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës.

PËRDORIMET

- I përshtatshëm për kontrollin e zonave anodike (Parimi 11, metoda 11.1, EN 1504-9)
- I përshtatshëm si prajmer, pjesë e sistemit për riparimin e betonit
- I përshtatshëm si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës, pjesë e sistemit për riparimin e betonit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Certifikatë CE sipas EN 1504-7
- Mund të aplikohet me furçë ose me teknikën e spërkatjes së lëngët
- Lehtësi në përdorim, thjesht shtoni ujë
- Ndërkapje mbi beton dhe çelik
- Rezistencë e mirë ndaj depërtimit të ujit dhe klorureve

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performancë si produkt për mbrojtje kundër korrodimit sipas EN 1504-7:2006, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë, të lëshuar nga organi i njoftuar i kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimin e llojit.
- Matje e rezistencës elektrike të llaçit sipas EN 12696-IBU Rapperswill, data 08.10.2011.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	çimento Portland, tym silici (silica fume), pluhur me polimere të shpërndara, agregate të përzgjedhura dhe aditivë
Ambalazhi	thes 25 kg ose 2 x qese 5 kg ne ambalazh plastik
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri
Jetëgjatësia	12 muaj
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të vulosur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe të freskëta në temperatura midis +5°C dhe +35°C.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët ~2.0 kg/l
Përmbytja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.01 % (EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	~50 MPa pas 28 ditësh	(EN 12190)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	~2.0 MPa pas 28 ditësh	(EN 1542)

Rezistenca ndaj difuzionit të avujve të ujit ~ 300 $\mu\text{H}_2\text{O}$

Rezistenca ndaj difuzionit të dioksidit të karbonit ~ 3800 μCO_2

Prova e korrodimit

Kalon

(EN 15183)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Sika MonoTop®-910 N është pjesë e serisë së llaçeve të Sika-s që plotësojnë pjesën përkatëse të Standardit European EN 1504 dhe përbëhet nga:

Prajmer / Mbrojtës kundër korrodimit të armaturës

Sika MonoTop®-910 N

Përdorim normal

SikaTop® Armatec® -110 EpoCem®

Kërkesa të larta

Llaç për riparime

Sika MonoTop®, SikaRep®

Llaçe për riparimin e betonit

Llaç për izolim & nivelim

Sikagard®-720 EpoCem®

Kërkesa të larta

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes

Për aplikim me furçë ~5.25 litra ujë (21%) për thes 25 kg
Për aplikim me spërkatje ~5.0 litra ujë (20%) për thes 25 kg

Konsumimi

Prajmer - Varet nga ashpërsia e nënshtresës dhe trashësia e shtresës së aplikuar. Si udhëzim, ~1.5-2.0 kg pluhur për m² për mm trashësi.
Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës - Si udhëzim, ~2.0 kg pluhur për m² për 1mm trashësi shtrese

Rendimenti

25 kg pluhur prodhon afërsisht 14.3 litra

Trashësia e shtresës

Si prajmer - mjaftueshëm për të veshur sipërfaqen e betonit me një shtresë të hollë për mbushjen e pabarazive, poreve dhe gropave të vogla
Si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës - min. 2 mm trashësi

Temperatura e mjedisit

+5°C minimum; +30°C maximum

Temperatura e nënshtresës

+5°C minimum; +30°C maximum

Koha e punueshmërisë

~90 deri në 120 minuta në +20°C

Koha e pritjes / mbiveshja

Aplikoni llaçin për riparimin e betonit të lagësht në të lagësht mbi prajmerin
Aplikoni llaçin për riparimin e betonit të lagësht në të thatë mbi mbrojtësin kundër korrodimit të armaturës

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Betoni:

Betoni duhet të jetë i plotësisht i pastër, pa pluhur, materiale të lira, ndotës sipërfaqësorë dhe materiale të cilat reduktojnë ngjitjen dhe parandalojnë përthithjen ose lagjen nga materialet riparuese. Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar, i shkatërruar dhe kudo që nevojitet edhe betoni shëndetshëm, duhet të hiqet me mjetet e përshtatshme.

Armatura prej çeliku:

Ndryshku, smërçi, llaçi, betoni dhe materiale të tjera të lira dhe dëmtuese që pengojnë ngjitjen apo ndikojnë në korrodimin, duhet të hiqen. Sipërfaqet duhet të

përgatiten me teknika pastrimi abraziv ose curril uji në presion të lartë deri në SA 2 (ISO 8501-1)
Referohuni edhe tek EN1504-10 për kërkesa specifike.

PËRZIERJA

Sika MonoTop®-910 N mund të përziet me mikser manual në shpejtësi të ulët (<500 rpm) ose me dorë për sasi të vogla.
Hidhni sasinë e rekomanduar të ujit brenda një kove. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, hidhni pluhurin dhe përzieni për të paktën 3 min.

APLIKIMI

Si prajmer: Rekomandohet që e gjithë nënshtresa e përgatitur të laget paraprakisht 2 orë përpara

aplikimit. Sipërfaqja duhet të mbahet e lagur dhe nuk duhet të thahet. Përpara aplikimit hiqni ujin e tepërt p.sh. me sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë paraqitje mat të errët pa shkëlqim. Poret apo gropëzat mbi sipërfaqe nuk duhet të përmbajnë ujë. Duke përdorur një furçë të pastër, rul apo pajisje spërkatjeje mbulonin nënshtresën me një veshje të hollë për të mbushur pabarazitë, gropëzat dhe poret.

Si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës: Duke përdorur furçën e përshtatshme apo pajisjen e spërkatjes, aplikoni shtresën e 1-rë në trashësi ~1mm për të veshur shufrat e armaturës. Kur veshja e parë të jetë e fortë në prekje me thoin e gishtit, aplikoni shtresën e 2-të në trashësi ~1mm. Nëse do përdoret metoda me spërkatje, mbronin nënshtresën nga spërkatja e tepruar duke fshirë çdo akumulim të përqëndruar dhe prisni derisa të thahet plotësisht përpara aplikimit të llaçit për riparim.

METODA E MATURIMIT

Si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës - mbronin menjëherë llaçin e freskët nga tharja e parakohshme & kontaminimi me një metodë të përshtatshme maturimi.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Për më shumë informacione lexoni Method Statement për riparimin e betonit me sistemin Sika MonoTop® ose EN 1504-10
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ose erë të fortë dhe/ose shi
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika MonoTop®-910 N

Prill 2019, Botimi 01.01

020302020010000050

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaMonoTop-910N-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf



BUILDING TRUST